



KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

**nga procesverballi i mbajtur më 6 dhjetor 2011, në mbledhjen e XVIII
(tetëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve nr. 31 dhe filloi në orën 11.00.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj , z. Radisav Peroviq, z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Liman Zeqiri dhe Millomir Jovanoviq, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, z. Reshadija Regjepagiq, Ministria për Komunitete dhe Kthim, z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë Podujevë, z. Hilmi Mehmeti, Policia kufitare Veriu, z. Bekim Karagjija, OSBE dhe z. Tamas Csote, LMT – KFOR- Hungarez.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 8 nëntor 2011

z. Liman Zeqiri, theksoi, në diskutimin tim në faqen e dytë të ekstraktit nuk është shënuar: “Personat e riatdhesuar të cilët merren me zeje të ndryshme nëse dëshirojnë mund të vazhdojnë një biznes të atillë, kërkesë të cilën e vlerëson Komisioni i veçantë i Ministrisë për Integritet Evropian dhe në rastet kur plotësohen kriteret e parapara mund të jepen deri 10.000 €”.

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri me plotësimin e paraqitur.

3. Përgatitjet e familjeve të komuniteteve pakicë për sezonin e dimrit me theks të veçantë sigurimi i druve për ngrohje

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, Komuna e ka realizuar një projekt për ndarjen e druve për ngrohje në sasi prej 2 m.³ për 100 familje me gjendje të rëndë

sociale dhe se në kuadër të këtij projekti përfituese kanë qenë 10 familje të komuniteteve ashkalinj dhe rom dhe shtoi, lidhur me ndarjen e druve ka pasur ankesa të shumta ngase numri i familjeve në nevojë është i madh, mirëpo mundësitë kanë qenë vetëm për sasinë e cekur të druve. Përndryshe e falënderoj Udhëheqësinë komunale për kujdesin ndaj familjeve në nevojë e cila e ka bërë traditë që këtyre familjeve t'iu ndajë ndihma gjatë festave të Bajramit dhe Vitit të Ri.

z. Reshadija Regjepagiq, parafolësin e pyeti, çfarë kriteresh janë përdorë për ndarjen e druve për ngrohje.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, u përgjigj, zyrtari kompetent i Komunës më ka kërkuar listën prej 10 emrave të kryefamiljarëve, ndërsa unë e kam ngritur Komisionin dhe në bazë të propozimeve që i ka bërë unë e kam dorëzuar listën e kërkuar, mirëpo duhet të ceku se 50% e familjeve ashkalinj dhe rom kanë nevojë për dru për ngrohje ngase janë në gjendje shumë të rëndë sociale, por siç e ceka më parë mundësitë kanë qenë vetëm për këtë sasi të druve.

z. Nebih Behluli, nënvizoi, jemi në dijeni se shumica e qytetarëve janë në gjendje të rëndë ekonomike sociale dhe shumë familje nuk janë në gjendje t'i përmbushin as nevojat esenciale, andaj kjo ndihmë është e mirëseardhur, mirëpo duhet bërë përpjekje për gjetjen e ndonjë donatori eventual në mënyrë që të sigurohet ndihma përkatëse edhe për një numër të familjeve të cilat nuk kanë përfituar në këtë projekt.

z. Burhan Blakçori, theksoi, projekti për ndarjen e druve për ngrohje është i qëlluar kur dihet se nevojat janë shumë të mëdha, ndërsa sa i përket sasisë së druve jam i mendimit se kjo është caktuar në bazë të mundësive, kjo vlen të përhëndetet aq më tepër kur dihet se Komunitat tjera nuk ndajnë ndihma të këtilla. Deri në ditët e sotme temperaturat nuk kanë qenë të ulëta mirëpo tash e tutje sigurisht se ditët e dimrit do të jenë më të ftohta e më këtë edhe nevojat për dru të ngrohjes do të jenë edhe më të mëdha, andaj nëse gjendet ndonjë donator do të ishte sukses.

z. Liman Zeqiri, theksoi, në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është sektori përkatës i cili sipas mundësive buxhetore ofron ndihma të ndryshme familjeve që janë në gjendje të rëndë sociale, gjithherë 10% e ndihmave destinohen për familje të komunitetit ashkalinj dhe rom në bazë të listave të cilat i sjellin përfaqësuesit e komuniteteve të cekura.

4. Të ndryshme

z. Radisav Peroviq, theksoi, në një mbledhje paraprake është vendosur që një grup prej tre vetash të shkojë në Prishtinë dhe të shikojë se a mund të bëhet diçka në mënyrë që vizitorët të mos kenë problem me rastin e ardhje vajtjes në fshatin Merergoc përkatësisht lagjen e sekiraqëve dhe shtoi, jam i interesuar të di se a ka diçka lidhur me këtë çështje.

Tash, vazhdoi ky diskutues, kemi probleme shumë të mëdha, po e përmendi se kohë më parë kam shkuar në Medvegjë për të blerë barna për gruan dhe zarzavate mirëpo në kthim më ka ndalë policia përkundër faktit se më njohin shumë mirë, gjithashtu e kam cekur më parë kur policia ka ardhur te shtëpia ime dhe më shumë se gjysmë ore më kanë mbajtur nën kërcënim për të më dërguar në Lluzhan. Policia thotë se e kryen punën e vet mirëpo ne pësojmë aq më tepër kur

ne gjithsej jemi 6 individ e prej tyre 4 invalid, gjithashtu nuk mund t'i mbajmë ritualet fetare, andaj në kushtet aktuale ne në asnjë mënyrë nuk mund të mbijetojmë.

Reshadija Regjepagiq, parafolësit iu përgjigj, lidhur me çështjen e kalimit të vijës kufitare ne jemi marrë vesh që grupi përkatës t'i drejtohet Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila është kompetente për çështjen e cekur.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, z. Radisav Peroviqi këtë çështje e ka shtruar edhe në mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe përgjigjja nga Komandanti i Policisë ka qenë që për këtë çështje përmes Komitetit për Komunitete duhet drejtuar institucioneve kompetente.

z. Hilmi Mehmeti, nënvizoi, Policia kufitare është shumë mirë e njoftuar me çështjen të cilën e shtroi z. Radisav Peroviq, mirëpo do theksuar se në asnjë mënyrë dhe në asnjë rrethanë askush nuk ka të drejtë të kalojë vijën kufitare përveç pikave doganore dhe shtoi, i vetmi institucion që mund ta zgjidh këtë çështje është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar se në atë trevë jetojnë qytetarë të moshuar deri tash kemi qenë fleksibil por kohëve të fundit atje ka filluar kontrabanda e kafshëve nga Serbia në Kosovë, për çka kemi gjetur dëshmi të pamohueshme, andaj mbi të gjitha ne jemi të obliguar të zbatojmë ligjin.

Prej 28 nëntor 2011, vazhdoi ky diskutues, kemi marrë në mbikëqyrje Stacionin e policisë kufitare në fshatin Kërpimëh dhe se kjo trevë patullohet në vazhdimësi dhe përfundoi, nëse ka ndokush pyetje jam i gatshëm të përgjigjem.

z. Nebih Behluli, theksoi, përfaqësuesi i Policisë kufitare ishte mjaftë sqarues dhe bindës, andaj jam i mendimit se për këtë çështje nuk ka çfarë të diskutohet më tepër.

z. Tamas Csote, nënvizoi, LMT KFOR është i kënaqur ma bashkëpunimin shumë të mirë me Portën 3 andaj dëshiroj të falënderoj Policinë kufitare për bashkëpunimin e ndërsjellë.

z. Radisav Peroviq, theksoi, te ne janë vjedhë tri lopë, rreth 500 m³ dru që afërsisht bëjnë 10.000 € si dhe janë pre 11 shtylla elektrike dhe se për këto nuk është zbardhur asnjë rast, andaj derisa gjithë këto nuk paraqesin problem, problem paraqet nëse unë e kaloj vijën kufitare.

z. Arbresha Hetemaj, theksoi, i kuptoj shqetësimet e z. Radosav Peroviqit mirëpo për këtë çështje ky Komitet i është drejtuar Zyrës së Kryeministrit por gjithashtu duhet pas parasysh se Kosova është shtet dhe se kalimi ilegal i kufirit është i ndaluar në çdo shtet dhe për një vepër të tillë pason dënimi adekuat.

z. Radisav Peroviq, parafolëses iu përgjigj, ajo çfarë thatë për mua është e qartë, mirëpo konsideroj se në rastin konkret duhet pasur tolerancë.

z. Burhan Blekçori, theksoi, këtë çështje disa herë e kemi shqyrtuar në mbledhje të këtij Komiteti dhe kemi ndarë shqetësimin tonë me z. Radisavin dhe se për zgjidhjen e kësaj çështjeje ju kemi drejtuar Kabinetit të Kryeministrit – Zyrës për Komunitete.

z. Liman Zeqiri, nënvizoi, e kuptojmë gjendjen e atyre qytetarëve të cilët përveç se janë të moshuar janë edhe të sëmurë, ne në cilësinë e strukturave komunale kemi bërë gjithë atë çka ka qenë në mundësitë tona, përndryshe Komandanti i Policisë kufitare këtë çështje e sqaroi në mënyrë shumë të qartë por na mbetet të shpresojmë se brenda një kohe të shkurt ky problem do të zgjidhet.

U theksua se për shkak të disa njerëzve të pandërgjegjshëm të cilët bëjnë tregti të palejueshme tash pësojnë qytetarët e asaj lagjeje, mirëpo përkundër kësaj ne duhet të bëjmë përpjekje të gjejmë mënyra që ata qytetarë dhe vizitorët e tyre në të ardhmen të mos kenë probleme të kësaj natyre.

z. Radisav Peroviq, theksoi, ka 12 vite që ka ardhur KFOR-i dhe gjatë gjithë kësaj kohe në asnjë rast me asnjë ushtar nuk kemi pas kurrë as problemin më të vogël.

z. Millomir Jovanoviq, theksoi, sa i përket vijës kufitare kemi dallime ngase njëra anë këtë e konsideron kufi shtetëror ndërsa ne e konsiderojmë kufi administrativ, mirëpo pavarësisht nga kjo të gjithë po pajtohemi se z. Radisavi ka probleme të mëdha meqë kufirin e ka afro 500 m. gruan e ka të sëmurë dhe jetën kryesisht e ka të ndërlidhur me pjesën në anën tjetër të kufirit.

Komandanti i Policisë kufitare tregoi se kanë gjetur gjurmë të kontrabandës së kafshëve, pra për shkak të keqpërdorimit të dikujt tash çdo kush dyshon në çdokënd.

Do theksuar se ky Komitet kurrë nuk është shmangur që maksimalisht të shqyrtoj shqetësimet e z. Radisavit të cilin e sugjeroj që për çdo rast eventual të lajmëroj Policinë kufitare apo Stacionin e policisë.

z. Tamas Csote, LMT KFOR, theksoi, jam në dijeni se çështja për të cilën po debatohet është ngritur shumë herë, mirëpo për këtë duhet pritur mendimin zyrtar nga institucionet kompetente. Unë në radhë të parë do të thosha duhet pasë durim ngase fillimisht duhet zgjidhur disa çështje madhore e më vonë do të zgjidhen edhe çështjet më të vogla.

Plotësisht pajtohem se çdo person që jeton në lagjen e sekiraqëve ka vështirësi dhe i kuptoj shqetësimet e tyre, mirëpo kërkoj që ata të bashkëpunojnë me policinë në parandalimin e kontrabandës, kuptohet nëse kanë informata.

Ky Komitet në mënyrë konkrete duhet të apelojë në Nivelin qendror që të merret përgjigje lidhur me këtë çështje ka raste kur një informatë e thjeshtë mund të ndihmoj në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme.

Së dyti jam i interesuar të di se a ka mundësi Komuna të furnizoj me ujë vendbanimet të cilat kanë problem me ujë të pijes.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, parafolësin e njoftoi se lidhur me shqetësimet e z. Radisav Peroviqit ky Komitet ka bërë dhe do të bojë gjithë atë që është në kompetencat dhe mundësitë e tij dhe shtoi, sa i përket ujit të pijes problemet më të theksuara janë në fshatin Orllan, mirëpo Komuna nuk ka pas mundësi dhe nuk ka bërë asgjë në këtë aspekt.

Mbledhja përfundoi në orën 12.10'.

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01/216-06

**Podujevë,
6 dhjetor 2011**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**